

Statistikat e transportit*

Prill 2021

Tiranë, më 27 Maj 2021: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Prill 2021 është 451,6 mijë ton, duke u rritur 27,7 % krahasuar me Prill 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Prill për periudhën 2018-2020, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është rritur 24,6 %.

Në katërmujorin e parë vitit 2021, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 1.531,9 mijë ton, duke u rritur me 18,1 %, krahasuar me katërmujorin e parë të vitit 2020.

Në muajin Prill 2021, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 2.333 mijë ton-kilometër, duke u rritur 3,1 herë, krahasuar me Prill 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Prill për periudhën 2018-2020, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është rritur me 30,5 %.

Në katërmujorin e parë vitit 2021, volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 10.436 mijë ton-kilometër, duke u rritur me 11,1 %, krahasuar me katërmujorin e parë të vitit 2020.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Me det/ton	Hekurudhë 000/ton.km	Ajër/ton*
Prill 2018	358.584	1.332	194
Prill 2019	375.425	3.281	186
Prill 2020	353.480	752	80
Mesatarja Prill (2018-2020)	362.496	1.788	153
Prill 2021	451.551	2.333	161
Janar-Prill 2020	1.296.791	9.394	591
Janar-Prill 2021	1.531.913	10.436	610

* Përfshin mallrat dhe postën

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Në muajin Prill 2021, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 161 ton, duke u rritur 2 herë, në krahasim me Prill 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Prill për periudhën 2018-2020, volumi i mallrave të transportuara me ajër është rritur me 4,9 %.

Për publikim 27/05/2021

Në katërmujorin e parë të vitit 2021, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 610 ton duke u rritur me 3,2 %, krahasuar me katërmujorin e parë të vitit 2020.

Në Prill 2021, numri i fluturimeve të kryera është 1.204 duke u rritur 7,9 herë, në krahasim me Prill 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Prill për periudhën 2018-2020, numri i fluturimeve është ulur me 16,4 %.

Tab. 2 Treguesit specifike të transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore*	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Prill 2018	19	1.992	12.589
Prill 2019	19	2.178	13.526
Prill 2020	16	152	1.429
Mesatarja Prill (2018-2020)	18	1.441	9.181
Prill 2021	14	1.204	4.294
Janar-Prill 2020	16	4.896	29.477
Janar-Prill 2021	14	4.342	16.724

*Numri i kompanive ajrore i referohet numrit të kompanive të cilat janë licensuar të kryejnë fluturime në fillim të vitit

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Në Prill 2021, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 30.413 pasagjerë. Krahasuar me Prill 2020, ky tregues është rritur 9,6 herë. Krahasuar me mesataren e muajve Prill për periudhën 2018-2020, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është ulur me 33,4 %.

Në katërmujorin e parë të vitit 2021, kanë udhëtuar me linjë detare 118.715 pasagjerë, duke u ulur me 8,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Në muajin Prill 2021, transporti ajror i pasagjerëve zë 76,7 % të transportit gjithsej.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në Prill 2021 është 101.354 pasagjerë duke u rritur 25,4 herë krahasuar me Prill 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Prill për periudhën 2018-2020, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është ulur me 33,2 %.

Në katërmujorin e parë të vitit 2021, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është 342.804 pasagjerë duke u ulur me 34,0 %, krahasuar me katërmujorin e parë të vitit 2020.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Prill 2018	7.571	58.093	211.651
Prill 2019	6.711	75.792	239.465
Prill 2020	0	3.170	3.983
Mesatarja Prill (2018-2020)	4.761	45.685	151.700
Prill 2021	414	30.413	101.354
Janar-Prill 2020	64	128.980	519.489
Janar-Prill 2021	1.596	118.715	342.804

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Eksportet/imporet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Prill 2021, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 91,6 mld lekë dhe 46,8 % e tyre u transportua me det. Në katërmujorin e vitit 2021, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 334,0 mld lekë dhe 49,4 % e tyre u transportua me det.

Eksportet e mallrave

Në Prill 2021, mallrat e eksportuara me det zënë 51,5 %, me rrugë 41,1 % dhe me ajër 0,3 %. Mallrat e eksportuara me rrugë në Prill 2021 janë rritur me 54,2 %, krahasuar me Prill 2020. Eksportet e mallrave të transportuara me rrugë në Prill 2021 janë rritur 23,0 %, krahasuar me mesataren e muajve Prill për periudhën 2018-2020.


Tab.4 Eksporti i mallrave sipas mënyrave të transportit

Periudha	Eksport (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudhë	Me rrugë	Me ajër	Të tjera
Prill 2018	14.903	7	9.121	112	2.592
Prill 2019	14.550	-	12.007	48	145
Prill 2020	6.882	-	7.647	30	363
Mesatarja (2018-2020)	12.111,7	2,3	9.591,5	63,3	1.033,4
Prill 2021	14.777	-	11.793	80	2.042
Janar-Prill 2020	47.677	-	31.231	344	1.502
Janar-Prill 2021	61.053	1	39.692	266	7.904

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Në katërmujorin e parë të vitit 2021, mallrat e eksportuara me det zënë 56,1 %, me rrugë 36,4 % dhe me ajër 0,2 %. Mallrat e eksportuara me rrugë janë rritur 27,1 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Prill 2021



Importet e mallrave

Në Prill 2021 mallrat e importuara me det zënë 44,6 % me rrugë 49,9 % dhe me ajër 4,0 %.

Mallrat e importuara me rrugë në Prill 2021 janë rritur me 68,6 % krahasuar me Prill 2020. Importet e mallrave të transportuara me rrugë në Prill 2021 janë rritur 40,9 % krahasuar me mesataren e muajve Prill për periudhën 2018-2020.


Tab.5 Importi i mallrave sipas mënyrave të transportit

Periudha	Import (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudh	Me rrugë	Me ajë	Të tjera
Prill 2018	27.210	152	23.464	1.529	190
Prill 2019	28.050	472	24.785	1.540	2.392
Prill 2020	15.585	294	18.625	925	974
Mesatarja (2018-2020)	23.615,0	306,0	22.291,4	1.331,7	1.185,5
Prill 2021	28.068	325	31.401	2.501	633
Janar-Prill 2020	84.550	1.156	78.219	5.087	5.438
Janar-Prill 2021	104.091	1.244	108.074	7.381	4.302

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ilogaritje të INSTAT

Në katërmujorin e parë të vitit 2021, mallrat e importuara me det zënë 46,2 %, me rrugë 48,0 % dhe me ajër 3,3 %. Mallrat e importuara me rrugë janë rritur me 38,2 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Prill 2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ilogaritjet të INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash